

Partia Demokratike

KOMISIONI I ORGANIZIMIT DHE KONTROLLIT TË OPERACIONEVE ELEKTORALE

Nr. 140 prot.

Tiranë, më: 12.05.2026

UDHËZIM

Nr. 5, datë 12.05.2026


PËR RREGULLOREN E BRENDSHME MBI MODALITETET E PROCESIT ZGJEDHOR PËR KRYETAR TË PARTISË DEMOKRATIKE

Në zbatim të neneve 10, 41, 46, dhe 53, të Statutit të Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe vendimit nr. 35, datë 17.03.2026 të Kryesisë të PDSH, Komisioni i Organizimit dhe Kontrollit të Operacioneve Elektorale (KOKOE),

UDHËZON:

I. Të përgjithshme

1. Zgjedhjet bëhen me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas modaliteteve të parashikuara në këtë udhëzim. Anëtarët e partisë me të drejtë vote e ushtrojnë lirisht të drejtën e votes;
2. Ndjekja, drejtimi dhe organizimi i procesit në nivel Dege bëhet nga Kryesia e Degës, e cila është përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit në nivel Dege;
3. Vëzhguesi i përhershëm i kandidatit caktohet pranë KOKOE, brenda datës 13 maj 2026, një. Ai duhet të jetë anëtar i PD;
4. Vëzhguesi ka akses të plotë në të gjithë veprimtarinë e Komisionit. Ai njoftohet dhe merr pjesë në çdo mbledhje të KOKOE dhe merr fjalën sa herë e kërkon për të parashtruar kërkesa, propozime apo ankesa;
5. Degët e Partisë janë përgjegjëse për organizimin e takimeve me anëtarësinë e partisë në degë, sipas një grafiku që dërgohet paraprakisht nga KOKOE;
6. KOKOE ka përgjegjësinë të japë akses të plotë dhe të menjëhershëm në listën zgjedhore. Ky akses fitohet menjëherë pas regjistrimit të çdo kandidati nga KOKOE;




Partia Demokratike

KOMISIONI I ORGANIZIMIT DHE KONTROLLIT TË OPERACIONEVE ELEKTORALE

7. Fushata zgjedhore fillon më datë 15 Maj 2026 dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve.

II. Procesi i Votimit

1. Kryesia e degës së PD-së organizon dhe është përgjegjëse për procesin e votimit për Kryetar të PDSH-së që do të zhvillohet me datë 23.05.2026.
 - Në çdo degë të PDSH-së ngrihen qendrat e votimit. Degët i propozojnë KOKOE numrin dhe mjediset ku do të mbahet votimi për të qenë lehtësisht të aksesueshme nga çdo anëtar;
 - Mjediset ku do të kryhet votimi miratohen nga KOKOE me propozim të kryesive të degëve jo më vonë se data 17.05.2026;
 - Në selinë qendrore të PDSH do të ngrihet qendra e votimit për degën Tirana 2, në të cilën përveç votuesve të kësaj dege do të votojnë edhe anëtarët e Kryesisë së Partisë Demokratike si dhe anëtarët e Këshillit Kombëtar me banim në Tiranë.
2. Komisioni i Votimit dhe Numërimit përbëhet nga 3 anëtarë të caktuar nga KOKOE, me propozim të Kryesisë së Degës, si dhe përfaqësues të secilit kandidat. Komisioni i Votimit dhe Numërimit ka në përbërje të paktën 3 anëtarë si më poshtë:
 - Një nga Nënkryetarët e Degës – Kryetar;
 - Dy anëtarë të Kryesisë së degës–anëtarë.
3. Në rast se dega ka më shumë se një qendër votimi, në rolin e kryetarit të komisionit zgjedhor mund të jetë një nga kryetarët e grupseksion-it/ve që mbulon territorin;
4. Kryesia e degës përcjell përbërjen e Komisionit, së bashku me të dhënat e kontaktit të secilit anëtar në Komisionin Zgjedhor, brenda datës 17.05.2026;
5. Fleta e votimit miratohet nga KOKOE jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve;
6. Kryetari i Komisionit të Votimit dhe Numërimit nënshkruan dhe vulos çdo Fletë Votimi.
 - Komisioni është përgjegjës për tërheqjen e bazës materiale jo më vonë se 1 ditë përpara fillimit të procesit të votimit. Materialet e votimit tërhiqen në Selinë Qendrore të PDSH-se brenda orës 16:00 të datës 22/05/2026, nga Kryetari i Komisionit, i cili mund të shoqërohet edhe nga anëtarët e tjere, nëse këto të fundit dëshirojnë;




Partia Demokratike

KOMISIONI I ORGANIZIMIT DHE KONTROLLIT TË OPERACIONEVE ELEKTORALE

- Baza materiale përfshin: fletët e votimit, procesverbalin, listat e votimit, dhomat e fshehta, kutitë e votimit, dhe cdo material tjetër të nevojshëm zgjedhor.
7. Qendrat e votimit hapen në orën 08:00 dhe mbylLEN në orën 18:00.
 - Komisioni i Votimit dhe Numërimit merr masa për hapjen e QV në orën e përcaktuar;
 - Votimi mbyllet në orarin e përcaktuar, duke u siguruar që në mjediset e QV nuk ka anëtarë që presin për të votuar. Nëse ka ende anëtarë të PD-së që presin të votojnë përtej orarit të caktuar për mbylljen e qendrës së votimit, sigurohet që kushdo që është në rradhë për të votuar të ketë mundësi për të votuar. Qendra e votimit nuk mbyllet deri në përfundimin e votimit të tyre. Mbyllja e votimit shpallet më zë të lartë dhe pas atij momenti nuk lejohet asnjë person tjetër që të votojë.
 8. Të drejtën për votim e ka çdo anëtar partie që ka emrin e tij ne listat e zgjedhësve, si dhe çdo anëtar tjetër partie, i cili edhe pse nuk e ka emrin në listat e zgjedhësve, është i pajisur përveç letërnjoftimit të tij, me një dokument origjinal që vërteton anëtarësinë e tij në Partinë Demokratike;
 9. Votuesi paraqitet përpara Komisionit me mjet identifikimi (kartë identiteti, pasaportë, apo patentë) dhe ia dorëzon atë për verifikim anëtarit të Komisionit që është caktuar përgjegjës për administrimin e Listës së zgjedhësve. Kryetari i Komisionit pajis votuesin me Fletën e Votimit dhe kujdeset që votuesi të votojë në dhomën e fshehtë dhe pa asnjë ndërhyrje të jashtme;
 10. Kutitë e votimit, fletët e papërdorura, të dëmtuara, listat e votuesve dhe procesverbali i mbylljes së votimit administrohen nga Komisioni i Votimit dhe Numërimit.

III. Mbyllja e Votimit dhe Procesi i Numërimit

1. Kryetari i Komisionit shpall me zë të lartë mbylljen e procesit të votimit dhe menjëherë fillon procesin e përgatitjes së ambientit të QV për realizimin e procesit të Numërimit. Procesi i Numërimit të votave fillon jo më vonë se 30 minuta nga mbyllja e procesit të votimit;
2. Pas mbylljes së votimit dhe administrimit të të gjithë dokumentacionit, Komisioni i Votimit hap kutitë dhe kryen numërimin e votave. Numërimi i votave kryhet nga Komisioni i Votimit dhe Numërimit. Numërimi bëhet në prani të të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe është i hapur për mediat;



Partia Demokratike

KOMISIONI I ORGANIZIMIT DHE KONTROLLIT TË OPERACIONEVE ELEKTORALE

3. Nëse ndonjë nga anëtarët e Komisionit ka kontestim apo vëren ndonjë problematikë në procesin e numërimit, ai kontakton KOKOE dhe i shpreh shqetësimin. KOKOE nëse vlerëson se është rasti, urdhëron Komisionin e Votimit të pezullojë procesin e numërimit dhe i shpreh shqetësimin që ka marrë. Pas sqarimit dhe zgjidhjes së problematikës, Komisioni me urdhër të KOKOE vijon procesin e numërimit dhe/ose rregullon mangësinë apo problematikën që është ngritur;
4. Në përfundim të procesit të Numërimit, Komisioni i Votimit dhe Numërimit, harton procesverbalin e procesit të votimit dhe numërimit. Procesverbali nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit të Votimit dhe Numërimit. Në këtë moment bëhet mbyllja e materialeve në kutinë e votimit nga Kryetari i Komisionit dhe materialet dorëzohen pranë KOKOE menjëherë pas përfundimit të procesit;
5. Me hartimin e procesverbalit përfundimtar të zgjedhjeve, Kryetari i Komisionit të Votimit dhe Numërimit, si dhe përfaqësuesit e kandidatëve, dorëzojnë në KOKOE deri në orën 08:00 të datës 24.05.2026. Në çdo rast një kopje elektronike e procesverbalit përfundimtar dërgohet menjëherë pranë KOKOE;
6. KOKOE pasi administron procesverbalet dhe materialet zgjedhore, në prani të mediave dhe përfaqësuesve të kandidatëve bën tabelën përmbledhëse të votave dhe shpall zyrtarisht brenda datës 24.05.2026 rezultatin paraprak.

IV. Dispozita të fundit

1. Ngarkohen Kryesitë e Degëve të Partisë Demokratike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.





Partia Demokratike

KOMISIONI I ORGANIZIMIT DHE KONTROLLIT TË OPERACIONEVE ELEKTORALE

ANËTARËT

Alban Volshe

Geart Shorinaku

Lini Lasso

[Signature]

Eno Boda



[Signature]

